

ENKELEIDA KAPIA

**REMA DHE KONTRASTI  
NË GJYMTYRËZIMIN AKTUAL TË FJALISË**

*Gjymtyrëzimi aktual* është paketa informuese (angl. information packaging) e një fjalie, e cila tregon se si shtohet informacioni gjuhësor në një ligjërim të caktuar (Firbas, 1964, 1971; Contreras, 1976; Chafe, 1976 etj.) Sipas perspektivës dinamike funksionale, një kontekst apo një ligjërim shihet si një *gjendje informative* (angl. information state), kurse thëniet që thuhet a shtohen në këtë kontekst shihen si *përditësime të informacionit* (information update) që përmban vetë konteksti. Thëniet mund të përmbajnë diçka të njohur më parë nga konteksti ose diçka të re, gjë e cila i shtohet kontekstit apo gjendjes informative. Dy thënie të njëjta (me përmbajtje kuptimore të njëjtë) mund të gjymtyrëzohen ndryshe në kontekste të ndryshme ligjërimore (pra, nëse përditësojnë gjendje informative të ndryshme). Le të shohim shembujt e mëposhtëm nga (1) - (4):

- 1) Konteksti: Si janë tubat?  
*Tubat janë të ndryshkur.*
- 2) Konteksti: Po tubat ç'kanë?  
*Tubat janë të ndryshkur.*
- 3) Konteksti: Pse del ujë me ngjyrë kafe nga rubineti?  
*Tubat janë të ndryshkur.*
- 4) Konteksti: Cilët janë të ndryshkur?  
*Tubat janë të ndryshkur.*

Tek shembulli (1), nga konteksti, dimë që kemi disa tuba të cilët janë në një gjendje të caktuar. Për rrjedhojë *tubat janë* përbën informacionin e njohur në kontekst, ndërkohë që *të ndryshkur* shpreh informacionin e ri, i cili i shtohet kontekstit të njohur. Tek (2) nga konteksti dimë vetëm që disa tuba kanë diçka, por se çfarë nuk dihet. Pra *tubat* përbëjnë informacionin e njohur. Kur shtojmë fjalinë e dytë, shtojmë gjithashtu edhe pjesën e re në kontekst *janë të ndryshkur*. Tek shembulli (3) konteksti na bën të njohur faktin që nga rubineti del ujë me ngjyrë kafe dhe duam të dimë përse ndodh kjo. Me anë të fjalisë pasardhëse, shtojmë edhe informacionin e ri që na bën të ditur arsyen që *tubat janë të ndryshkur*. Ndërsa tek shembulli (4), konteksti na bën të ditur që ka disa elemente që janë të ndryshkur dhe duam të dimë se cilat janë këto. Kjo bën që *janë të ndryshkur* të jetë informacion i njohur në fjali, ndërkohë që fjalia që vijon shton informacionin e ri *tubat*.

Mbi gjymtyrëzimin aktual në shqipe kanë punuar qysh herët albanologë të shquar. Fillesat këto studime i kanë qysh me gjuhëtarët I. D. Sheperi, P. Novak e duke vijuar edhe me vonë me gjuhëtarët N. Barri, S. Floqi, Sh. Demiraj, M. Totoni, Th. Rrushi, dhe R. Përnaska. Përgjithësisht këta autorë kanë qenë të mendimit që në gjymtyrëzimin aktual të fjalisë në shqipe, në varësi nga intonacioni, rendi i fjalëve, trajta e emrit dhe prania ose mosprania e trajtave të shkurtra të përemrave, çdo gjymtyrë fjalie mund të jetë temë ose remë. Këto dy koncepte janë vendosur në kuadrin e perspektivës funksionale të fjalisë, term ky i sjellë në studimet e shqipes nga Remzi Përnaska. Ky term shpreh faktin që kjo teori u krijua nga ithtarët e shkollës funksionaliste të Pragës. Të gjithë autorët që kanë punuar për të zbërthyer më mirë perspektivën funksionale të fjalisë në shqipe janë të mendimit që tema shpreh të dhënën në një kontekst caktuar, ndërsa rema shpreh të renë në po këtë kontekst. Më poshtë vijon një shembull i nxjerrë nga puna e M. Totonit në të cilin *zjarret* sipas kontekstit të Totonit është tema, ndërsa *udhëtarë* është rema. Për sa i përket foljes *ndillnin* Totoni nuk shprehet fare nëse kjo është pjesë e temës apo pjesë e remës, gjithmonë sipas kontekstit që ka zgjedhur vetë autori.

5) Zjarret ndillnin udhëtarë.

(Totoni, 1981, f. 16)

Disa nga dukuritë gjuhësore të studiuara dhe njëkohësisht më të spikatura në literaturë që lidhen drejtpërdrejt me gjymtyrëzimin aktual të fjalisë janë:

- a) Bashkëpërdorimi i kundrinorit me trajtat e shkurtra të përemrit vetor
- b) Rendi i fjalëve në fjali
- c) Shtegtimi (term i Përnaskës) i disa gjymtyrëve të pjesës së nënrenditur në pjesën kryesore

Një nga dukuritë sintaksore më të rrahura është ajo e bashkëpërdorimit të kundrinorit me trajtat e shkurtra të përemrit vetor. Për rolin e trajtave të shkurtra si mjet shprehës të gjymtyrëzimit aktual është thënë se kundrina e drejtë në një fjali që ka trajtë të shkurtër në kallëzore, nuk mund të jetë kurrë remë (Sheperi, 1927; Novak, 1958; Floqi, 1969; Barri, 1975; Demiraj, 1975; Totoni, 1980; Rrushi, 1984). Por shih Përnaska (1986) i cili ka argumentuar që prania ose mungesa e trajtës së shkurtër nuk shërben mirëfilli për shprehjen e gjymtyrëzimit aktual për disa arsye. Floqi (1969) në artikullin e tij *Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme* shprehet se gjymtyrëzimi aktual lidhet thjesht me momente stilistike "...rastet e rendit të rëndomtë ose të drejtë për shkak të gjymtyrëzimit aktual dallohen nga rastet e rendit të anasjelltë për shkak të disa nuancave stilistike" Megjithatë, autori nuk futet në shpjegime apo ilustrime të thelluara të pohimeve të mësipërme.

Në artikullin e tij, R. Përnaska (1979), mbi shtegtimin e gjymtyrëve të pjesës së nënrenditur në pjesën kryesore pohon se, “rendi i gjymtyrëve është i lidhur ngushtë me perspektivën funksionale, me gjymtyrimin aktual.” (f. 155). Më tej, Përnaska shprehet se: “Ky rend i veçantë që rrjedh nga shtegtimi vjen si pasojë e perspektivës funksionale, për spikatjen ose jo të një gjymtyre të fjalisë. Kjo spikatje ose mosspikatje mund të shpjegohet me faktorë psikologjikë. Ky rend shfaqet më shpesh në gjuhën e folur, por jo edhe aq rrallë edhe në gjuhën e shkruar.” (f. 158).

Pra, deri më tani, për shqipen ndarja e gjymtyrëve të fjalisë në planin e gjymtyrëzimit aktual është bërë në temë dhe remë. Kjo ndarje është lidhur thjesht ose me momente stilistike (Floqi), ose me faktorë psikologjikë (Përnaska). Përgjithësisht, në literaturën e përmbledhur më lart, prania e remës lidhet me theksin logjik në fjali. Pra, një element është remë kur mbart theksin logjik, domethënë mbart një lloj theksi intonativ, që i jep fjalës së theksuar vlera suplementare lartësie, intensiteti, e gjatësie (Boriçi, 1987). Kjo lloj ndarjeje e paketës informative ose ky lloj strukturimi informativ i një fjalie a një thënieje lë pa zgjidhur disa raste të shqipes, cilat po i ilustruam me shembujt e mëposhtëm. Si i analizojmë fjalitë (7) dhe (8) në planin e gjymtyrëzimit aktual? Çfarë i dallon këto fjali nga njëra tjetra?

- 6) Ç’pije të pëlqen?
- 7) **Vera** më pëlqen.
- 8) **Vera** më **pëlqen**. (por jo vera)

Në një fjali, si fjalia (8), e cila mbart dy theksa intonativë, cila është rema? Dhe në qoftë se njëri element i theksuar është remë, çfarë është elementi tjetër? A është e reja gjithmonë thjesht remë?

### **Rema dhe kontrasti**

Në këtë artikull do të propozojmë që elementet e reja në një fjali a një thënie janë ose remë ose kontrast. Rema, e hulumtuar gjerësisht në studimet e shqipes, përfaqëson elementin e ri, ose të panënkuptuar në fjali a kontekst. Kontrasti, i njohur pak ose aspak në këto studime, përbën atë nocion që nga shumë semanticienë e sintaksologë të huaj është quajtur “fokus paradigmatic” (për një përmbledhje të gjerë të elementeve operacionale të kësaj kategorie shih Erteschik-Shir 1986). Konkretisht, nocioni i kontrastit mund të përkufizohet si vijon: *nëse një shprehje është kontrastive, një bashkësi M {..., a, ...} gjenerohet dhe bëhet e disponueshme në ligjërim në formën e një domeni sasior (angl. quantificational domain) i cili përdoret për kompjutacione semantike*. Po ashtu, Rooth (1985, 1992) shprehet që kur në ligjërim kemi kontrast, në këtë rast vëmë re që gjenerohet një bashkësi alternativash, e cila shërben si informacion shtesë (angl. additional denotation)

për kompjutacionin semantik të elementit të fokusuar. Të gjitha elementet alternative të bashkësisë që gjenerohet duhet a) të përputhen me elementin e fokusuar në llojin semantik dhe b) të jenë të krahasueshme me të sipas ontologjisë së tyre dhe kontekstit në të cilin ndodhen (Krifka, 1991). Nisur nga motivime konceptuale dhe empirike, këtu do të argumentojmë që në shqipe përveç remës, në strukturimin informativ të fjalisë kemi edhe kontrast i cili del i qartë sintaksorisht dhe semantiksht si për shqipen, dhe me sa dimë, edhe për shumë gjuhë të tjera.

Ideja, që në gjuhë ekzistojnë dy tipa fokusi, ka kohë që është prezantuar në literaturën gjuhësore (Halliday, 1967; Rochemont, 1986) edhe pse emërtimet e këtyre tipave nuk kanë qenë gjithmonë të njëjta (fokus kontrastiv vs. fokus prezantues, fokus i ngushtë vs. fokus i gjerë, fokus identifikues vs. fokus informativ, etj.). Në këtë studim unë do t'i përmbahem terminologjisë remë dhe kontrast. Në shqipe, këto dy kategori dallohen nga katër tipare kryesore, të cilat do t'i trajtojmë më poshtë. Disa nga këto tipare janë tipare semantike, kurse disa janë tipare sintaksore.

- Tipari 1: Rema shpreh thjesht elementin e ri të një fjalie, kurse kontrasti nuk është thjesht (ose gjithmonë) e reja. Kontrasti përfaqëson një element nga një bashkësi elementesh për të cilat jep informacion edhe vetë predikati i fjalisë.
- Tipari 2: Pozicioni strukturor i kontrastit në fjali nuk është i hapur për çdo element të mundshëm. Kjo nuk është e vërtetë për pozicionin e remës.
- Tipari 3: Kontrasti është ai që mundëson shprehjen e plotë të fushës (*angl.* scope) semantike dhe sintaksore të disa elementeve.
- Tipari 4: Kontrasti shtegton ose mund të rrijë në vend (në rend të drejtë), kurse rema nuk lëviz asnjëherë.

Më poshtë do të shqyrtojmë këto tipare një e nga një, duke i ilustruar me shembuj konkretë. Duhet theksuar që shembujt janë marrë të gjithë me kundrinorë, për lehtësi ilustrimi të kësaj dukurie.

Së pari, marrim në shqyrtim tiparin e parë, sipas së cilit, ndërkohë që rema shpreh thjesht elementin e ri të një fjalie, kontrasti nuk është thjesht (ose gjithmonë) e reja. Ai përfaqëson një element nga një bashkësi elementesh për të cilat jep informacion edhe vetë predikati i fjalisë. Këtë dallim mund ta shohim mjaft qartë në qoftë se kemi një kontekst të tillë në të cilin një vajzë, *Ana, blen diçka për vete*. Nëse këtij konteksti i shtojmë pyetjen në (9) vëmë re që vetëm përgjigja në (10), në të cilën theksi i frazës (ose *theksi frazor*, shih Lumnije Boriçi, (1987) për një diskutim më të gjerë mbi këtë çështje) bie mbi elementin 'një kapele', është një përgjigje e pranueshme në shqipe, duke marrë parasysh natyrën e hapur të pyetjes paraprijëse.

9) Çfarë bleu Ana për vete?

- 10) Ana bleu *një kapele* për vete.  
 11) \*Ana *një kapele* bleu për vete.

Tek (10) 'një kapele' në pozicionin pasfoljor (rend i rëndomtë) shpreh thjesht elementin e ri në ligjërim. Tek (11) 'një kapele', në pozicionin menjëherë para foljes dhe e spikatur edhe me anë të theksit frazor, përfaqëson një artikull që bleu Ana nga një bashkësi e tërë artikujsh që Ana mund të blinte (një pallto, një shall, një palë këpucë, madje edhe një makinë).

Tipari i dytë ,që i dallon këto dy kategori në shqipe ,është i lidhur me kufizimet që mbartin pozicionet e remës dhe të kontrastit. Pozicioni parafoljor i kontrastit në fjali nuk është i hapur për çdo element të mundshëm. Kjo, nga ana tjetër, nuk është e vërtetë për pozicionin e remës. Le të marrim disa shembuj. Në fjalinë e mëposhtme (12) shohim në pozicionin parafjalor një sintagmë emërore e cila është kontrastive (mbi të bie dhe theksi i frazës):

- 12) Ana *një kapele* bleu për vete.

Në shqipe, në qoftë se sintagma emërore shprehet me emër të shoqëruar me përemër të pacaktuar, nuk është e mundur ta vendosësh në pozicionin parafoljor. Një shembull i tillë është ai në (13) i cili është jogramatikor për shqipen.

- 13) \*Ana *çdo kapele* bleu për vete.

Gjithashtu, kur emri është i shoqëruar me pjesëzën shtuese (*e*)dhe, nuk është e mundur ta përdorësh në pozicionin parafoljor, siç është ilustruar edhe në fjalinë (14).

- 14) \*Ana (*e*)dhe *një kapele* bleu për vete.

Këto sintagma emërore të shoqëruara me përemër ose me pjesëzën aditive (*e*)dhe janë plotësisht të mundshme në pozicione pasfoljore, pozicion ky të cilin e kemi shoqëruar me remën. Shembujt për këtë janë më poshtë tek (15) dhe (16).

- 15) Ana bleu *çdo kapele* për vete.  
 16) Ana bleu (*e*)dhe *një kapele* për vete.

Pra, fakti që (15) dhe (16) janë gramatikore në shqipe, ndryshe nga (13) dhe (14), tregon që pozicioni parafoljor dhe pasfoljor i këtyre sintagmave nuk është i njëjtë.

Së treti, kontrasti është ajo kategori që mundëson shprehjen e plotë të funksionit që ka konteksti semantiko-sintaksor i disa elementeve në fjali. Më specifikisht, kontrasti ka lidhje të ngushtë me një element në të majtë të tij, lidhje e cila i lejon të shprehë plotësisht funksionin e tij semantik dhe sintaksor. Ky element është shpeshherë një kuantifikues (*angl.* quantifier).

Rema, nga ana tjetër, nuk mund të lidhet me një përemër në të majtë të saj për arsye ligjërimore-semantike. Për të ilustruar këto ndryshime, marrim në shqyrtim dy situata ligjërimore.

Kemi situatën ligjërimore A, ku Ana ishte e vetmja vajzë me të cilën donte të kërcente çdo djalë. Kishte edhe vajza të tjera në sallë, por jo çdo djalë donte të kërcente me to. Dhe gjithashtu, kemi edhe situatën ligjërimore B ku janë disa djem dhe Ana; çdo djalë donte të kërcente me Anën. Vëmë re që në shqip situatën A dhe situatën B i shprehim me fjali të ndryshme. Situata A në të cilën Ana ishte e vetmja vajzë (nga vajzat e tjera në sallë) me të cilën donte të kërcente çdo djalë e shprehim me fjalitë në (17) dhe (18), kurse situatën B në të cilën disa djem donin të kërcentin me të vetmen vajzë në sallë, Anën, e shprehim si në shembullin (19):

(17) Çdo djalë donte të kërcente me Anën. (Kontrast)

(18) Me Anën donte të kërcente çdo djalë. (Kontrast)

(19) Çdo djalë donte të kërcente *me Anën*. (Remë)

Në pozicionin parafjalor, elementi ‘Anën’ është kontrast dhe lidhet ngushtë me kuantifikuesin ‘çdo’. Në semantikë do të thoshim që ‘Anën’ ka shtrirje semantike mbi ‘çdo’ (*angl.* semantic scope), kurse në sintaksë kjo shtrirje do të karakterizohej nga c-komanda (shih, ndër të tjera, Memushaj, 2008 për konceptin e c-komandës). Pra, elementi ‘Anën’ e c-komandon elementin ‘çdo’ dhe anasjelltas. Kjo shtrirje semantike e këtyre elementeve mbi njëri-tjetrin mundëson kuptimin semantik (dhe funksionin sintaksor njëkohësisht) ku Ana është e vetmja ndër të tjera me të cilën do të kërcejë çdo djalë. Ndërsa rasti kur Ana nuk është një ndër të tjera nuk parashtron nevojën që ky element të ketë shtrirje mbi kuantifikuesin.<sup>1</sup>

Së katërti, sikurse është përmendur edhe më lart, kontrasti është një element i cili shtegton ose mund të rrijë në vend (në rend të drejtë), kurse rema nuk lëviz asnjëherë nga pozicioni i saj pasfoljor. Tek (20) ‘supë me perime’ është remë, ndërkohë që tek (21) dhe (22) i njëjti element është kontrast. Pra, rema mund të jetë vetëm në pozicion pasfoljor, kurse kontrasti mund të dali në pozicion pasfoljor dhe parafoljor.

<sup>1</sup>Rasti i shtrirjes semantike është trajtuar qysh herët në literaturën gjuhësore nga Montague (1974) dhe May (1977). Për të evidentuar më qartë kontekstet a) kur një element ka shtrirje semantike mbi një tjetër dhe b) kur një element nuk ka shtrirje semantike mbi një tjetër, janë marrë fjali si e mëposhtmja: *Çdo fermer ka një qen*.

Kjo fjali ka dy kuptime. Në kuptimin e saj të parë, çdo fermer ka qenin e tij. Në kuptimin e dytë, çdo fermer ka të njëjtin qen. Është pikërisht kuptimi i parë rasti kur kuantifikuesi ‘çdo’ ka shtrirje semantike mbi çdo element që c-komandon. Në kuptimin e dytë kjo shtrirje semantike mungon.

- (20) Beni hëngri supë me perime.  
 (21) Beni supë me perime hëngri. (jo byrek)  
 (22) Beni hëngri supë me perime. (jo byrek)

Kemi paraqitur këtu disa argumente paraprake për dallimin konceptual dhe empirik të remës dhe temës në shqipe. Duhet theksuar që ky dallim konceptual midis këtyre dy kategorive është bërë i qartë edhe për shumë gjuhë të tjera. Për të shprehur këto dy nocione/koncepte të ndryshme, disa gjuhë shfrytëzojnë sintaksën, disa të tjera morfologjinë, kurse disa të tjera fonologjinë. Disa gjuhë shfrytëzojnë disa burime njëherazi. Rema dhe kontrasti shprehet nëpërmjet sintaksës në gjuhën hungareze (E. Kiss, 1998), në gjuhën greke (Tsimpli, 1994), në gjuhën rumune (Goebbel, 1996), italiane (Belletti & Schlonsky, 1996), katalaneze (Bonnet, 1990; Vallduvi & Vilkuuna, 1995), finlandeze (Vilkuuna, 1994), dhe në gjuhën arabe (Ouhalla, 1994). Në anglisht, rema dhe kontrasti shprehen nëpërmjet fonologjisë dhe, herë-herë, sintaksës (Jacobs, 1995). Dhe ndryshe nga shumë gjuhë të tjera, kategoritë e remës dhe kontrastit në japonisht shprehen nëpërmjet morfologjisë (Rizzi, 1995).

Mbështetur në punën e gjuhëtarëve sintaksologë si Spiro Floqi, mendojmë që koncepti i remës në gramatikën e shqipes mund të rishikohet në mënyrë që t'i lëshojë hapësirën e tij edhe konceptit të kontrastit. Sigurisht, përpos këtij studimi, lipsen edhe studime të tjera jo vetëm sintaksore, por edhe fonologjike për të kuptuar më mirë bashkekzistencën e këtyre dy kategorive në shqipe, gjë e cila çon në mënyrë të natyrshme në ripërpunimin e teorisë ekzistuese të gjymtyrëzimit aktual për shqipen. E rëndësishme është të theksohet këtu që një ripërpunim i kësaj teorie në mënyrë që të shprehë dallimin midis remës dhe kontrastit në shqipe, do të mund të shpjegojë, në shumicën e rasteve, edhe rendin e anasjellë të fjalëve në fjali për gjuhën tonë.

## BIBLIOGRAFI

- A. Belletti, U. Schlonsky, *The order of verbal complements: a comparative study*. Natural Language and Linguistic Theory 13, 1995, 489-526.  
 A. Dodi, *Ndarja aktuale e fjalisë dhe intonacioni në gjuhën shqipe*, në "Gjuha jonë", 1986/4, 5-8.  
 A. Dodi, *Ndarja aktuale e fjalive*, në "Gjuha jonë", 1984/4.  
 E. Bonnet, *Subjects in Catalan*. MIT Working Papers in Linguistics: Papers on Wh-Movement, 1990, 13.1-26.  
 E. Goebbel, *Focus movement in Romanian*. Tuebingen: University of Tuebingen, 1996.  
 E. Vallduvi & M. Vilkuuna, *On Rheme and contrast*. Journal of Syntax and Semantics, 29, 1995, 79-108.

- H. Contreras, *A theory of word order with special reference to Spanish*. North Holland. Amsterdam, 1976.
- I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskërishtes*. Vlorë, 1927.
- I. M. Tsimpli, *Focusing in Modern Greek*. In *Discourse configurational languages*, ed. by Katalin E. Kiss, New York and Oxford: Oxford University Press, 1994.
- J. Firbas, *On defining the theme in functional sentence perspective*. *Travaux linguistiques de Prague*, 1, 1964, 267-280.
- J. Firbas, *On the concept of communicative dynamism in the theory of functional sentence perspective*. *Brno Studies in English*, 7, 1971, 12-47.
- J. Ouhalla, *Focus in standard Arabic*. *Linguistics in Potsdam* 1, 1994, 65-92.
- K. E. Kiss, *Multiple topic, one focus?* *Acta Linguistica Hungarica* 45, 1998, 1-2.
- L. Boriçi, *Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe*, SF, 1987/2, 74-87.
- L. Rizzi, *The fine structure of the left periphery*. Geneva: University of Geneva, 1995.
- M. Halliday, *Intonation and grammar in British English*. The Hague: Mouton, 1967.
- M. Krifka, *A compositional semantics for multiple focus constructions*. In *Proceedings of SALT 1*, 127-158. Ithaca, N.Y.: Cornell University, 1991.
- M. Rochemont, *Focus in generative grammar*. Amsterdam: John Benjamins, 1986.
- M. Rooth, *A theory of focus interpretation*. *Natural Language Semantics* 1, 1992, 75-116.
- M. Rooth, *Association with focus*. Ph.D. dissertation, University of Massachusetts at Amherst, 1985.
- M. Totoni, *Çështje të gjymtyrëve të fjalisë*, SF, 1981/3, 113-114.
- M. Totoni, *Libri i gjuhës shqipe për klasën e VII*. Tiranë, 1971.
- M. Vilkuna, *Discourse configurationality in Finnish*. In *Discourse configurational languages*, ed. by Katalin E. Kiss, 244-68. New York & Oxford: Oxford University Press, 1994.
- N. Barri, *Albanais: themes, propos et pronoms atones*. *Bulletin de la Société de Linguistique de Paris*, 1975, 179-202.
- N. Erteschik-Shir, *Wh-questions and focus*. *Linguistics and Philosophy* 9, 1986, 117-149.

- P. Novak, *K zdojovani predmetu I albanistine*. Sbornik slavistckych praci venoranych mezinarnodnimu sjezdu slavstvu v Moske, IV, Universita Karlova, Praha, 1958, 27-32.
- R. C. May, *The Grammar of Quantification*. PhD dissertation: MIT, 1977.
- R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*. Tiranë: shblu, 2008.
- R. Montague, *Formal philosophy: selected papers of Richard Montague*, edited and with an introduction by Richmond H. Thomason, Yale University Press, New Haven, 1974.
- R. Përnaska, *Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe*, SF, 1979/1, 32-37.
- R. Përnaska, *Përshatja e trajtës së shkurtër dhe e kundrinës me njëra tjetrën, në "Gjuha jonë"*, 1984/1, 32-37.
- R. Përnaska, *Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë dhe gjymtyrëzimi aktual në gjuhën shqipe*, SF, 1986/2, 32-37.
- S. Floqi, *Gjymtyrëzimi aktual në shqipe*, SF, 1986/2.
- S. Floqi, *Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme*, SF, 1969/2, 155-159.
- S. Floqi, *Rreth modeleve të fjalisë në shqipen e sotme letrare*, SF, 1978/3, 39-45.
- Sh. Demiraj, *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1975.
- Th. Rrushi, *Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në shqipe*, SF, 1983/4, 47-56.
- W. I. Chafe, *Givenness, contrastiveness, definiteness, subjects, topics, and point of view*. In Charles Li (ed.), *Subject and Topic*, 25-55. New York: Academic Press, 1976.

## SUMMARY

### RHEMA AND CONTRAST IN THE INFORMATION STRUCTURE OF SENTENCE

The purpose of this article is to outline and to establish a conceptual distinction in Albanian between two interpretative notions often conflated behind the single term *focus*, the concept of *rhematicity* and the concept of *kontrast*. This distinction is empirically supported with data from the syntactic realization of rhematicity and kontrast in this language. These data are further supported with data from other typologically different and similar languages. In sum, it is shown here that both rhematicity and kontrast are present in the structure of Albanian and, as such, this evidence adds to the discussion of the problems that plague the *focus* literature for languages of the world.

